



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/204

Datë: 19.06.2020

Procesverbal

i mbledhjes se III (e tretë) të rregullt për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -II- të rregullt të KPF-së, për vitin 2020.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës të Komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve dhe emërtime të reja.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/45 datë:16.01.2020, të parashtruar nga Kryetari i Komunës, sipas kërkesës nr.09/02-MB datë: 09.01.2019, për caktimin e lokacionit për vendosjen e pikës së transferit, për grumbullimin, transportimin, depozitimin e mbeturinave (jo të ngurta) të cilat grumbullohen nga K.R.M Ekoregjioni Sh.a në Prizren, njësia në Malishevë.
4. Informimi nga KKSB për aktivitetet për vitin 2019.
5. Shqyrtimi i draft-Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve.
6. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/44 datë:20.01.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, sipas kërkesës së parashtruar nga përfaqësuesit e lagjes Kastrati nga fshati Damanek, për shpalljen e pronës publike të parcelës 299-1, për varreza të kësaj lagje në fshatin Damanek KK-Malishevë.
7. Shqyrtimi i Raporti vjetor të punës për vitin 2019 i Drejtorisë për Inspektorat.
8. Debat rreth raportit për pasurinë publike të Komunës.
9. Shqyrtimi i përgjigjes së kryetarit të Komunës nr.01/1399 datë: 21.11.2019, sipas shkresës përcjellëse nr.02/578 datë: 24.10.2019 për shqyrtimin e propozimit nr.02/498 datë:04.09.2019, për këmbim të pronës së paluajtshme private me pronë të Komunës së Malishevës të parashtruar nga Murtez Thaçi dhe Femi Thaçi nga fshati Mirushë .
10. Shqyrtimi i kërkesave
11. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 15.06.2020 duke filluar në ora 13:00, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, zyra për informim, drejtori i Drejtorisë për Inspektorat, Avokati i Komunës.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve jemi në mbledhjen e tretë, kjo mbledhje ishte e planifikuar të mbahet me datë:18.03.2020 por shkaku i pandemisë Covid-19 jemi detyruar t'i anulojmë të gjitha aktivitetet dhe s'kemi mund me te mbajmë mbledhje. Urojmë të kaloj sa me shpejtë kjo pandemi, i kemi disa pika shtesë tani besoj se kemi kushte për mbajtjen e mbledhjes pasi që salla është e dezinfektuar, tani kemi Raportin e Komitetit për Komunitete për vitin 2019, Raportin e Komitetit për Diasporë, Planin e Komitetit për Arsim për vitin 2020.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/410 datë:12.05.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, lidhur me zbatimin e kontratës kolektive të Arsimit dt.17.04.2017,

kërkesën nr.01/416 datë:14.05.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës për gjetjen e mundësisë së zgjidhjes për familjet të cilat duhet të zhvendosen me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në lagjen Matoshi në Malishevë, tani hapi debat.

Alban Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë kjo është mbledhja e parë pas ndërprerjes së punës së Kuvendit të Komunës dhe KPF-së për shkak të pandemisë, gjithë atyre që kanë qenë të infektuar ju urojmë shërim dhe uroj mos të kemi raste të reja. I shprehi ngushëllime familjes Begaj për humbjen e një anëtarit të familjes nga Covid-19, uroj që sa më shpejt të gjendet vaksina që të mundet ky virus.

Rahim Morina: Kush jeni për këtë rend të ditës me plotësim ndryshim dhe futje të këtyre pikave që ju informova që kemi tani.

Unanimisht ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -II- të rregullt të KPF-së, për vitin 2020.

Rahim Morina: Kush jeni për miratim të këtij procesverbali?

Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës të Komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve dhe emërtime të reja.

Rahim Morina: Sa i përket këtij raporti unë jam kanë kryetar i Komisionit, të gjitha kërkesat i kemi shqyrtuar dhe puna ka shkuar në nivel, tani e kemi raportin me listën përfundimtare të emrave.

Valon Krasniqi: Sa pash në raport në fshatin Bardh me duket se ka një gabim.

Hashim Vrenezi: Rreth raportit kam vërejtje sa pash ka emra familjar të refuzuar, por edhe emra të veprimtarëve por nuk pash ndonjë bazë mbi të cilat i kanë fut si veprimtar, pra si raport është i mangët. Në fshatin Marali të emri i një rrugë thuhet me propozim të qytetarëve por ska qene i qytetarëve të emri i mësuesit Ilaz.

Rahim Morina: Për me vnu një emër janë disa kritere, por ne fillimisht i kemi takuar krejt kryesitë e fshatrave, jemi konsultu jemi mundu që asnjë emër familjar mos me futë, sepse ka pas raste thoshin hiqni një veprimtar e fute emrin e familjarit.

Hashim Vrenezi: Për me votu këtë raport duhet dokumentacion shtesë me i detajuar.

Valon Krasniqi: Në raport thuhet ka qenë kërkesa e Refki Shijakut dhe kërkesë e aprovuar, po qysh ka qenë e aprovuar është dashtë të specifikohet.

Alban Krasniqi: Tash nga parafolesit ka vërejtje, por unë mendoj se mu hudoj gjitha ajo punë e mundimshme dhe voluminoze nuk është në rregull por ka qenë moment i mirë me vendosë standarde e jo mi qitë ndonjë rrugë shembull emër të ndonjë shpijuni. Duhet të mbështetet raporti me pas vendimmarrje me argumente në procedurë me dokumente të bazuara, se edhe kryesitë e fshatrave për me propozuar dike është dashtë për një figurë me dorëzuar se paku një letër të shkruar.

Rahim Morina: Ne në komision biografi për emra kemi pas pak, andaj i kemi konsultuar krejt kryetaret e fshatrave.

Hashim Vrenezi: Lidhur me këtë raport disa propozime nuk kanë qenë të qytetarëve.

Alban Krasniqi: Këtë raport ose duhet me votu ose me shty, por drejtoritë kanë përgjegjësi që brenda gjashtë muajve mi ba rregullimet.

Raimonda Krasniqi: E kemi ditur që procesi i emërimit të rrugëve nuk ka qenë i lehtë, pra ka qenë një punë mjaft e vështirë. Unë kur kam qenë drejtoreshë në shkollë para disa viteve, për me zgjedh një arsimtar të mirë është dashtë të përgatisim një biografi, por ka qenë injoruese me pas një biografi me dy rreshta në letër, unë jam që këtë raport ta rekomandojmë. Në fshatin Terpezë busti i Hasan Prishtinës ka qenë i granatuar, por ka pas individ që kanë thënë gjuajeni në ravinë.

Hashim Vrenezi: Nëse ka gabime teknike në raport duhet t'i eliminojmë, Agjencioni Kadastral dhe Drejtoria për Urbanizëm kanë vendosur lidhur me emrat dhe kriteret.

Hashim Vrenezi: Unë nuk po pajtoj me raport sepse janë vendosur dy standarde.

Rahim Morina: Kush jeni për rekomandim të këtij Raporti për Kuvend?

Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/45 datë:16.01.2020, të parashtruar nga Kryetari i Komunës, sipas kërkesës nr.09/02-MB datë: 09.01.2019, për caktimin e lokacionit për vendosjen e pikës së transferit, për grumbullimin, transportimin, depozitimin e mbeturinave (jo të ngurta) të cilat

grumbullohen nga K.R.M Ekoregjioni Sh.a në Prizren, njësia në Malishevë.

Hashim Vrenezi: Materiali s'është i kompletuar sepse kemi kërkuar një plan financiar.

Alban Krasniqi: Së pari duhet me ditë që këto deponi a janë të ligjshme, sepse nuk ka stacion të mbeturinave po depo, unë ku do që vendoset skam me lanë dhe duhet me ba organizim në çdo fshatë nëse vendoset me caktuar deponi.

Hashim Vrenezi: Nëse është në kundërshtim me Ligjin unë nuk e përkrahi këtë kërkesë.

Rrahim Morina: Nëse dëshironi në mund të kërkojmë sqarime ligjore se a ka të drejtë komuna me pas pikë transferi për mbeturina, pastaj mungon edhe kostoja financiare.

Rrahim Morina: Kush jeni që lidhur me këtë kërkesë të kërkojnë sqarime ligjore në MAPL?

Unanimisht ishin për.

4. Informimi nga KKSBB për aktivitetet për vitin 2019.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për kuvend.

Unanimisht ishin për.

5. Shqyrtimi i draft-Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve.

Hashim Vrenezi: Te neni 12 i kësaj draft-Rregullore duhet me ja përcaktuar limitin maksimal KPF-së.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për kuvend.

Unanimisht ishin për.

6. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/44 datë:20.01.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, sipas kërkesës së parashtruar nga përfaqësuesit e lagjes Kastrati nga fshati Damanek, për shpalljen e pronës publike të parcelës 299-1, për varreza të kësaj lagje në fshatin Damanek KK-Malishevë.

Rrahim Morina: Ne e kemi pas shqyrtuar edhe një herë këtë kërkesë, kemi kërkuar prej drejtorisë për Gjeodezi me dal në teren, ata kanë qenë teren, mirë po aty në fshat ka dy palë njëra kërkon për varreza, pala tjetër kundërshton si shihet ka probleme aty. Mirë ndoshta ka qenë këtë kërkesë tia përcjellim kryetarit të Komunës për trajtim. Sepse pala tjetër me vonë është ankuar.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë t'i përcillet kryetarit të Komunës.

Unanimisht ishin për.

7. Shqyrtimi i Raporti vjetor të punës për vitin 2019 i Drejtorisë për Inspektorat.

Drejtori Drejtorisë për Inspektorat Dibran Kastrati: Ky raport punë është për vitin 2019 ceken kërkesat, pastaj numri i gjobave mandatore. Furrat e gëlqeres i kemi ndalur, një është në fshatin Bardh edhe ajo duhet me rrenu. Në fokus kanë qenë edhe gurëthyesit, fabrikat e betonit, Ekoregjionit i kemi dhënë vërejtje, mirë është të gjendet një zgjidhje, sa i përket fushës së ndërtimit e kemi vetëm një inspektor.

Alban Krasniqi: Zgjidhja për ekoregjionin është Landovica, autoritetet janë të obliguara mu pais me leje mjedisore, me pas inspektime sanitare, a ka pas inskenime në furrat e gëlqereve. Sa i përket drejtorisë për Inspektorat sa punëtor jeni, numri është pak sidomos të inspektimi i ndërtimeve ty pas parasysh ndërtimet pa kritere dhe gjithandej, pra kërkoj të rritet edhe numri edhe të këtë më shumë inspektime.

Hashim Vrenezi: E falënderoj drejtorin për seriozitetin e punës të treguar në raport dhe është mirë kjo të përcillet edhe të drejtorët tjerë. Ju drejtor në drejtorinë e juaj s'keni kod të veçantë, por të një drejtorie tjetër pra duhet të pavarësoheni si drejtori.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për kuvend.

Unanimisht ishin për.

8. Debat rreth raportit për pasurinë publike të Komunës.

Hashim Vrenezi: Menaxhimi i pasurisë ka qenë edhe gjetje e Auditorit, në raport thuhet struktura dhe paisje tjera, por duhet te specifikohet se çka janë struktura tjera, pastaj të specifikohet për ndërtesat banesore, sipërfaqja e tyre, sa janë të lira dhe ato afariste, pastaj të qiratë e tokës sa janë të shfrytëzueshme dhe sa jo.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për kuvend.

Unanimisht ishin për.

9. Shqyrtimi i përgjigjes së kryetarit të Komunës nr.01/1399 datë: 21.11.2019, sipas shkresës përcjellëse nr.02/578 datë: 24.10.2019 për shqyrtimin e propozimit nr.02/498 datë:04.09.2019, për këmbim të pronës së paluajtshme private me pronë të Komunës së Malishevës të parashtruar nga Murtez Thaçi dhe Femi Thaçi nga fshati Mirushë.

Rrahim Morina: Sipas Ligjit të ri për dhënien në shfrytëzim kryetari inicion kërkesën kur ka këmbim prone, unë me palën një ditë me herët kam pas një konflikt të vogël bile atë dite e kemi pas mbledhjen e Kuvendit, pala ka ardhe nuk dojke që unë me ja sqaruar si janë procedurat për këmbim të pronës sipas Ligjit. Ai mu drejta mue thojke t'i je ka e pengon që spo ma miratoni kërkesën. Unë i kam thënë t'i mas pari lëndën e ke pas në Gjykatë, bile thojke dikujt kam meja maru vorrin e qesi fjalë. Sa i përket kësaj kërkesë unë juve me material të mbledhjes ju kam përcjellur në zarfe të gjithëve Ligjin, unë edhe sot du meju cek nen për nen sa çka thotë Ligji kur ka raste për këmbim të pronës.

Mujë Sahitaj-Avokati Publik: Ky rast është që prej vitit 2015 në procedurë gjyqësore, palët e kanë të pa mundur me gjete zgjidhje fjala është për një pronë të diga, atyre ndërtimi i digës ju ka dëmtuar pronën ashtu qysh po pretendojnë. Aty për atë vend ka edhe një ekspertizë nga një ekspert dhe pala si kundërshtpërblim për demin që ju ka ba në pronën e vet tash po kërkon afër Restorant Bimit me marrë pronë prej Komunës si këmbim me pronë private. Ata lëndën e kanë pas në Gjykatë por kompetent për me ba tash këmbimin e pronës sipas Ligjit është Kuvendi i Komunës.

Alban Krasniqi: Ne nëse ndërhyjmë këtu në krijojmë precedent sepse ka probleme edhe në fshatra tjera dhe shumë prona janë degraduar. Kryesues qytetari ka kërkuar këmbimin e pronës, por asnjë nen të Ligjit që e lexove t'i nuk përkon me kërkesën e qytetarit, sepse ka shumë raste dhe ne ku dojmë me përfunduar kështu.

Mujë Sahitaj: Pala në këtë rast e ka ndërruar kërkesë padinë, prej kompensimit demi tani për këmbim prone.

Alban Krasniqi: Organ me vendos për këtë rast është Gjykata, sepse aj atje se pari a drejtuar.

Hashim Vrenezi: Deri sa kryetari si ka respektuar hapat ligjor, bile ska vy mena sjellë hiq këtë kërkesë, por nëse mundemi kemi mundësi me kerku interpretim ligjor në MAPL.

Valon Krasniqi: Unë jam me dergu kërkesën në Kuvend.

Rrahim Morina: Kush jeni që këtë kërkesë ta përcjellim për MAPL për konsultim paraprak?

Për ishin 4, kundër s'kishte, abstenime 1.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/410 datë:12.05.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, lidhur me zbatimin e kontratës kolektive të Arsimit dt.17.04.2017.

Rrahim Morina: Lidhur me këtë kërkesë të arsimtarëve dy shkallet kanë vendosur që pagesa për shujta edhe paga jubilarë mi ekzekutuar.

Mujë Sahitaj: Këto janë për paga jubilarë dhe shujta të arsimtarëve, tash inspektorati ka marrë vendim për meju njofto për shujta dhe paga jubilarë. Për disa vendime veç Gjykata ka vendosur dhe i ka ekzekutuar, por nëse ne ankohe mi prapë ne krijojmë shpenzime tek përmbaruesi si dhe në gjykatë dhe prapë arsimtarët i marrin mjetet sipas këtyre vendimeve pasi janë të bazuar në kontratën kolektive të Arsimit.

Hashim Vrenezi: Si Kuvend e kemi bërë një ndarje buxhetore, por a neglizhuar nga qeveria komunale.

Mujë Sahitaj: Këto lënde prej avokatit kalojnë tek përmbaruesi.

Valon Krasniqi: Në po injorohemi sikur te vendimet tjera.

Raimonda Krasniqi: Unë jam që kjo kontratë të zbatohet sa më shpejtë, sepse Komuna sa kanë e interesuar deri tani, por mirë është që ne kuvend të dihet numri i mësimdhënësve, numri i atyre që kërkohet pagesa për shujta ushqimore pra edhe totali sa është. Po ashtu të jemi në dijeni se nga cilat projekte i merrni mjetet dhe çka është paguar me mjetet e ndara më herët.

Alban Krasniqi: Është shumë e madhe që kërkohet për mi ekzekutuar këto pagesa, çka bjen në përgjegjësi të Komunës dhe MEF-it. Po ashtu kërkohet informacion sa është lista e pensionistëve që janë paguar dhe që janë në proces për këtë vit.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për kuvend.

Unanimisht ishin për.

11. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të Komitetit për Komunitete për vitin 2020.

12. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit Janar-Dhjetor 2020 të Komitetit për Diasporë.

13. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Planit të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020.

Rrahim Morina: Kush jeni që këto dy raporte dhe një Plan i punës të rekomandohen për kuvend.

Unanimisht ishin për.

14. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/416 datë:14.05.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës për gjetjen e mundësisë së zgjidhjes për familjet të cilat duhet të zhvendosen me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në lagjen Matoshi në Malishevë.

Alban Krasniqi: Vendimi a marrë atëherë për ndërtim të shkollës, por kurrë ska ardhur informacion se sa familje janë në këtë objekt që tani kërkohet të rrenohet në mënyre që mi fut në buxhet për qiranë e tyre tani që duhet të strehohen dikund.

Hashim Vrenezi: Lidhur me këtë kërkesë kryetari i Komunës mundet meju kriju mundësi atyre familjeve pagesën e qerasë deri në një zgjidhje të përhershme.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për kuvend.

Unanimisht ishin për.

15. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.02/73 datë: 21.02.2020 e parashtruar nga Fadil Kastrati nga fshati Turjakë.

Alban Krasniqi: Qeveria është dashtë me ba specifikacion për pronat që janë të lira, sa janë të shfrytëzueshme sa jo.

Rrahim Morina: Kush jeni që këtë kërkesë ta përcjellim për zyrën e kryetarit të Komunës?

Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/97 datë: 26.02.2020 e parashtruar nga Fahredin Hazrolli, Hamit Hazrolli, Jeton Hazrolli nga fshati Banjë.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të refuzohet dhe palëve tu jepet përgjigje? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/108 datë: 06.03.2020 e parashtruar nga Libade Mazreku nga Malisheva.

Rrahim Morina: Kjo kërkesë sa shihet ka mungesë të dokumentacionit, mirë është më një shkresë të ceket kjo që dokumentacioni duhet të jetë i kompletuar, pala aty ku ka bërë kërkesë mundet të njoftohet.

Kërkesa nr.02/102 datë: 02.03.2020 e parashtruar nga Driton Thaqi nga fshati Shkarashnik

Rrahim Morina: Po ashtu edhe kjo kërkesë ka mungesë të dokumentacionit, mirë është më një shkresë të ceket kjo që dokumentacioni duhet të jetë i kompletuar, pala aty ku ka bërë kërkesë mundet të njoftohet.

Kërkesa nr.02/78 datë:20.02.2020 e parashtruar nga Grupi i anëtarëve të Kuvendit nga AAK

Rrahim Morina: Lidhur me këtë kërkesë unë do t'i thërras shefat e krejt grupeve në një takim.

16. Të ndryshme.

Hashim Vrenezi: Është mirë të kemi një raport lidhur me vendimin që kemi marrë si kuvend për ndarjen buxhetore lidhur me gjendjen e pandemisë Covid-19.

Rrahim Morina: Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 15:40

Procesmbajtësi

Naïm Avdijaj jur. i dip

Kryesuesi i Kuvendit

Rrahim Morina